



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 679/8 prot.

Tiranë, më 28.12.2020

**VENDIM**  
**Nr.208, datë 28.12.2020**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 148, DATË 16.11.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 148, datë 16.11.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë, filluar në bazë të ankesës së paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\*, në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2020, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, institucioni Bashkia Kamëz”.

**KONSTATOVA SE:**

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 679 prot., datë 11.9.2020, ankuesi \*\*\*\*\* ngriti pretendime se, niveli i vlerësimit i dhënë për periudhën janar-qershor 2020, nga eprori i tij është kryer në mënyrë subjektive dhe në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të përmendura në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Kamëz të dërgojë gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me procesin e transferimit të nëpunëses.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin nr.148, datë 16.11.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë, filluar në bazë të ankesës së paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\*, në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2020, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, institucioni Bashkia Kamëz”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz, me shkresën nr. 9341/1 prot., datë 26.11.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje

me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin dhe në pjesën arsyetuese të vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Kamëz, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, institucioni, me Urdhrin nr. 584, datë 20.11.2020, është bërë lirimi nga detyra i punonjësit në fjalë, për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit. Njëkohësisht, njësia përgjegjëse ka shpallur të lirë pozicionin “*Specialist Jurist*”, dhe është në proces për plotësimin e tij në përputhje me kërkesat ligjore.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 148, datë 16.11.2020, të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë, filluar në bazë të ankesës së paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\**, në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2020, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, institucioni Bashkia Kamëz”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Kamëz, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 148, datë 16.11.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kamëz dhe ankuesi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**